



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.164

3 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1077, datë 27.10.2009	Për miratimin e dokumentit strategjik kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”	7247
Vendim i KM nr.1081, datë 21.10.2009	Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit	7264
Vendim i KM nr.1084, datë 28.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zall-Bastar të qarkut të Tiranës	7268
Vendim i KM nr.1085, datë 28.10.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Orosh të qarkut të Lezhës	7269
Vendim i KM nr.1086, datë 28.10.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Librazhd të qarkut të Elbasanit	7271
Vendim i ERE nr.80, datë 23. 10. 2009	Për miratimin e modelit të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE)	7272
Vendim i ERE nr.81, datë 4.11.2009	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k.....	7279
Vendim i ERE nr.82, datë 4.11.2009	Për fillimin e procedurave për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.39, datë 22.07.2004 për shoqërinë “WTS ENERGJI” sh.p.k., të ndryshuar	7280
Vendim i ERE nr.83, datë 4.11.2009	Për licencimin e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	7281

Vendim i ERE
nr.84, datë 4.11.2009

Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Cez
Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë
elektrike 7282

Vendim i ERE
nr.85, datë 4.11.2009

Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Cez
Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të
kualifikuar të energjisë elektrike 7283

VENDIM
Nr.1077, datë 27.10.2009

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT STRATEGJIK KOMBËTAR “PËR HETIMIN E KRIMIT FINANCIAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit strategjik kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”, sipas tekstit, që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë gjatë zbatimit të dokumentit strategjik kombëtar të kryhen nga një grup teknik ndërinstitucional, përbërja e të cilit të përcaktohet nga Komiteti për Bashkërendimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave, i cili mbikëqyr veprimtarinë e këtij grupi e zbatimin e këtij dokumenti strategjik, si dhe bën rishikimin periodik të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHKURTIMET

PP	Prokuroria e Përgjithshme
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
PP	Prokuroria e Përgjithshme
FATF	Grupi i Veprimit Financiar
MSA	Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara/Konfiskuara
BE	Bashkimi Europian
BSH	Banka e Shqipërisë
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare
ILDKP	Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
KE	Këshilli i Europës
KKBLKPP	Komiteti Kombëtar për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NjPH	Njësia e Përbashkët e Hetimit të Krimit Ekonomiko-Financiar dhe Korrupsionit
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OSCE	Organizata për Bashkëpunim dhe Sigurinë në Europë
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror
ZQRP	Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZVRP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

HYRJE

Që prej fillimit të viteve nëntëdhjetë dhe gjatë viteve të tranzicionit nga diktatura në një sistem demokratik, Shqipëria është përballur me sfida të shumta, disa prej të cilave kanë qenë edhe lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimit ekonomik dhe financiar.

Integrimi gradual i Shqipërisë në komunitetin ndërkombëtar dhe aleancat euroatlantike si edhe marrëdhëniet gjithnjë në rritje me to, rritja e integritetit ndërkombëtar të kapitalit, globalizimit i sistemeve tregtare dhe financiare, intensifikimi i tregtisë ndërkombëtare, zhvillimi dhe përsosja e teknologjisë së informacionit, lëvizja e lirë e njerëzve, e mallrave dhe e pajisjeve, përveç zhvillimeve dhe progresit, krijojnë rreziqe dhe mundësi për krime financiare, pastrim parash dhe financim të aktiviteteve të lidhura me terrorizmin.

Krimi financiar, pastrimi i parave (një prej formave më tipike të krimit ekonomik – financiar përkufizohet si “një proces kompleks i fshehjes së origjinës së pasurive të siguruar në mënyrë ilegale”) dhe financimi i terrorizmit, përbëjnë një rrezik serioz për besueshmërinë e sistemit financiar.

Ato cenojnë rëndë stabilitetin ekonomik e politik dhe progresin e vendeve demokratike, forcimin e zbatimit të ligjit, sistemin demokratik në Republikën e Shqipërisë, konkurrencën e lirë në ekonominë e tregut, si dhe stabilitetin e vendit në përgjithësi. Ato shkaktojnë disekuilibra në raportet e kërkesës dhe ofertës, si dhe të raporteve makroekonomike, krijojnë instabilitet dhe ndikojnë në mënyrë negative në tregun e këmbimeve valutore.

Qeveria Shqiptare do të vazhdojë të punojë me partnerët ndërkombëtarë për të reformuar më tej legjislacionin aktual për luftën kundër krimit ekonomik në të gjitha format e tij, e të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në veçanti. Dokumenti strategjik do të evoluojë, bazuar në ndryshimet që do të ndodhin në fushën e krimit ekonomik – financiar.

Dokumenti Strategjik Kombëtar për hetimin e krimit financiar në Republikën e Shqipërisë përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe të instrumenteve që forcojnë dhe garantojnë sigurinë e qytetarëve, shoqërisë, shtetit shqiptar nga rreziqet e brëndshme dhe të jashtme, duke marrë në konsideratë gjëndjen ekonomike të vendit, rajonit dhe më gjërë, si dhe burimet dhe mundësitë ekzistuese në vend.

FAKTORËT STRATEGJIKË

Hartimi i këtij dokumenti strategjik bazohet në një analizë të kujdesshme të faktorëve të mëposhtëm si:

- Aktivitetet e krimit të organizuar, rreziqet që paraqesin për ekonominë shqiptare, mënyrat e veprimit, njohuritë e tyre specifike si dhe format e organizimit;
- Forcat dhe mjetet që janë në dispozicion të institucioneve shtetërore (burimet njerëzore si dhe mekanizmat e brëndshëm të kontrollit);
- Sfondi aktual në të cilin këto dy grupe faktorësh ndërveprojnë.

Bazuar në të dhënat historike, kategoritë kryesore të veprave penale, të cilat përmbajnë elemente të konsiderueshëm të krimit ekonomik dhe financiar, janë format e mëposhtme të krimit të organizuar, si:

- Trafikimi i narkotikëve dhe i armëve;
- Trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucioni;
- Kontrabanda, evazioni fiskal, korrupsioni, mashtrimi etj;

Grupet e krimit të organizuar, nëpërmjet procesit të pastrimit të parave, kërkojnë të tjetërsojnë të ardhurat e siguruar nga krimi në pasuri, të cilat shërbejnë për forcimin e mëtejshëm të elementit kriminal brënda shoqërisë.

Institucionet shtetërore shqiptare hasin një sërë dobësish në përpjekjet e tyre kundër krimit ekonomik dhe financiar, që kanë të bëjnë me burimet e kufizuara njerëzore e logjistike, si dhe me trajnimin e pamjaftueshëm të ekspertëve, të cilët ndërmarrin hetime financiare. Angazhimi dhe motivimi i nëpunësve dhe i ekspertëve në zbulimin e krimeve ka qënë gjithashtu një prej dobësive në fushën e zbulimit të krimeve. Disa nga masat e marra nga qeveria kanë qënë rritja e rrogave, e shpërblimeve dhe krijimi i institucioneve që sigurojnë qëndrueshmëri dhe mundësi përparimi për

specialistët.

Në mënyrë që të sigurohet efektivitet në luftën kundër fenomenit të krimit ekonomik - financiar, i cili evoluon në mënyrë të vazhdueshme, nevojiten njohuri të mira në fushën e kontabilitetit, në fushën bankare, të institucioneve të kreditit dhe të auditimit.

Krijimi i njësive të përbashkëta, të përbëra nga ekspertë të fushave të ndryshme të institucioneve shtetërore si dhe bashkëpunimi i tyre, do të çojë në rritjen e efektivitetit në përballjen me krimet financiare.

Mungesa e bashkëpunimit dhe e koordinimit ka qenë gjithashtu një nga pikat e dobta të institucioneve shqiptare, të cilat vazhdojnë të operojnë brenda kornizave të institucioneve të tyre, pa u përfshirë në mënyrë aktive në aktivitete të përbashkëta.

Mungesa e arkivave të dixhitalizuara dhe pamundësia e aksesimit të tyre nga institucionet partnere, është identifikuar si një mangësi. Progresi i arritur në këtë drejtim është i dukshëm në disa agjenci të zbatimit të ligjit. Krijimi i këtyre bazave të të dhënave dhe vënia e tyre në dispozicion të agjensive të inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit, është i detyrueshëm.

KAPITULLI I VIZIONI

Dokumenti Strategjik Kombëtar për hetimin e krimit financiar në Republikën e Shqipërisë synon të luftojë në mënyrë aktive dhe të pandërprerë krimin ekonomik – financiar, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat dëmtojnë rëndë stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit, sigurinë kombëtare e në tërësi, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

PARIMET DHE STANDARDET

Ky dokument synon të krijojë një platformë afatgjatë veprimi dhe të vendosë një ekuilibër ndërmjet parandalimit efektiv dhe hetimeve të krimeve në fushën ekonomik - financiare.

Dokumenti Strategjik Kombëtar bazohet në parimet e mëposhtme:

- Efektiviteti – i ruajtjes dhe i konsolidimit të sistemit të kontrollit;
- Proporcionaliteti – përqëndrimi i burimeve në fushat prioritare;
- Angazhimi/Gjithpërfshirja – komunikimi i vazhdueshëm dhe efektiv me institucionet shtetërore, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe shoqërinë civile;
- Perspektiva globale - rritja e vazhdueshme e partneritetit me organizmat ndërkombëtar në luftën kundër krimit financiar.

Institucionet shtetërore të përfshira në zbatimin e tij do të vendosin standarde, bazuar në respektimin e vlerave si: integriteti, përkushtimi dhe profesionalizmi.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Objektivat e Dokumenti Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”, në planin afatmesëm dhe afatgjatë do të jenë:

- Hartimi dhe harmonizimi i legjislacionit me standartet ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë;
- Rritja e efektivitetit të kontrollit, mbikqyrjes për zbatimin e legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Rritja e nivelit profesional dhe kapaciteteve njerëzore të institucioneve shtetërore të përfshira në hetimin e krimit financiar;
- Evidentimi dhe dokumentimi më efektiv i hetimit të krimeve financiare;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar;
- Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e luftës kundër krimit financiar si dhe rolit të institucioneve shtetërore;
- Forcimi i kapaciteteve parandaluese të agjensive të zbatimit të ligjit dhe krijimi i mekanizmave adekuat për këtë qëllim;

KAPITULLI II

KUADRI INSTITUCIONAL

Në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë dhe funksionojnë një sërë institucionesh të përfshira në luftën kundër krimit ekonomik - financiar, përgjegjësitë, funksionet dhe baza ligjore e të cilëve përshkruhen në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Institucioni i Prokurorisë është një organ kushtetues, i centralizuar (sui generis), i cili funksionon sipas organizimit të sistemit gjyqësor. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon se Prokurori i Përgjithshëm është i pavarur dhe kompetent për ndjekjen e çështjeve penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, në emër të shtetit.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës, me pëlqim të Kuvendit, ndërsa prokurorët emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm miraton strukturën, organikën dhe rregullat e funksionimit të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit, në Prokurorinë e Përgjithshme si dhe nxjerr urdhra dhe udhëzime për ushtrimin e detyrave nga ana e prokurorëve.

Në vitin 2004 u krijua Prokuroria e Krimeve të Rënda për hetimin e veprave penale të kryera nga grupet e strukturuar dhe organizatat kriminale, trafiket e ndryshme si dhe aktet terroriste. Po kështu, në muajin maj 2007, u krijua Njësia e Përbashkët Hetimore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si një strukturë e specializuar për hetimin e krimit ekonomik - financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Krijimi i kësaj Njësie u shoqërua me krijimin edhe të gjashtë njësive të tjera të ngjashme në rrethet Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Gjirokastrë dhe Korçë, të cilat kanë në përbërje të tyre oficerë të policisë gjyqësore, të Prokurorisë, Policisë së Shtetit, Doganave edhe Tatimeve si dhe ndërlidhës me ILDKP, KLSH, DPPP dhe SHISH.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Ministria e Drejtësisë funksionon në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ajo ka detyrën dhe përgjegjësinë për konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e drejtësisë. Për realizimin e këtyre detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, Ministria e Drejtësisë harton dhe ndjek politikën, përgatit aktet ligjore dhe nënligjore, ofron asistencën ligjore nëpërmjet opionencës së iniciativave ligjore të ndërmarra nga institucionet e tjera dhe pjesëmarrjen në grupet e punës të ngritura për këtë qëllim. Ministria e Drejtësisë, gjithashtu, ushtron shërbimet e nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj, sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Ministria e Drejtësisë ka një rol të rëndësishëm në hartimin e legjislacionit në luftën kundër krimit financiar dhe si autoritet mbikqyrës ndikon në rritjen e numrit të njoftimeve të aktiviteteve të dyshimta për pastrimin e parave nga ana e noterëve.

ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe e ushtron veprimtarinë e saj mbështetur në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar; ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, si dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore. ZQRPP luan një rol të rëndësishëm në dedektimin e aktiviteteve të dyshimta të materializuara në pasuri të paluajtshme, të cilat ia dërgon DPPP.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), luan rolin e Njësies së Inteligjencës Financiare dhe ka për mision parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, analizës dhe

dhënies së informacionit për agjensitë e zbatimit të ligjit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit, pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale.

Drejtoria bashkërendon punën me struktura të tjera të zbatimit të ligjit, të tilla si: Ministria e Brëndshme, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ Kombëtar dhe me Organizma homologë e Institucione ndërkombëtare. Njësia e Inteligjencës Financiare gjithashtu harton programe bashkëpunimi dhe asistencë të ndërsjellë në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave, me vende të ndryshme, në bazë të konventave ndërkombëtare të nënshkruara dhe të ratifikuara.

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Nenet 4 dhe 82 të MSA-së, Qeveria Shqiptare është plotësisht e angazhuar për të forcuar autoritetin e luftës kundër pastrimit të parave me origjinë nga trafiqet ilegale dhe terrorizmi si dhe për dekriminalizimin e aktivitetit ekonomik në vend. Në këtë mënyrë, synohet që t'i shërbehet rritjes së besueshmërisë në sistemin ekonomik dhe ligjor në vend.

Fuqizimi i kapaciteteve në këtë drejtim do të ketë vëmendjen kryesore, me qëllim arritjen e rezultateve të dukshme dhe konkrete. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, qeveria shqiptare do të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë veçanërisht me parandalimin e pastrimit të parave. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare do të bashkëpunojë me vendet e tjera, me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe përdorimin e tyre për qëllime të financimit të terrorizmit.

Legjislacioni bazë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave përbëhet nga Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Terrorizmit” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Me qëllim zbatimin e standardeve për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka nënshkruar një sërë memorandumesh bashkëpunimi me disa agjensi të zbatimit të ligjit në vend si edhe me njësitë e inteligjencës financiare të vendeve të tjera.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) është institucion në varësi të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave përcaktohen në Kodin Doganor, në vendime të Këshillit të Ministrave, në udhëzime të Ministrit të Financave dhe në akte të tjera administrative të DPD.

Për të realizuar një performancë më të mirë, në plotësim të Misionit të tij Mbrojtës, Shërbimi Doganor Shqiptar ka realizuar gjatë vitit 2008 ngritjen e një strukture të re, objekti i punës i së cilës fokusohet tërësisht në linjën e sigurisë. Kjo strukturë është Drejtoria Antitrafik, në përbërje të së cilës funksionon edhe Sektori i parandalimit të pastrimit të parave. Kjo strukturë punon për të zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe bashkëpunon ngushtë me DPPP-në.

Drejtimet kryesore të punës së Shërbimit Doganor Shqiptar për parandalimin e pastrimit të parave janë monitorimi dhe dokumentimi i lëvizjes së parasë cash, evidentimi i rasteve të transaksioneve të dyshimta dhe realizimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

Aktualisht, DPD ka arritur të realizojë marrëdhënie bashkëpunimi funksionale me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti i Kufirit dhe Migracionit), Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, me të cilat ka nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi. Një bashkëpunim optimal është realizuar edhe me Prokurorinë, ku pjesë e NjPH për luftën kundër krimit financiar janë edhe oficerët e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka autoritetin për të zbatuar legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për të administruar tatimet, taksat e tarifatat kombëtare.

Qëllimi kryesor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është të ndihmojë tatimpaguesit për të paguar detyrimet e tyre tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto detyrime të shkojnë për llogari të buxhetit të shtetit, duke i ofruar tatimpaguesve një sistem pagese eficient dhe efektiv.

Administrata tatimore bashkëpunon ngushtë me Doganat, Drejtorinë e Thesarit, Drejtoritë Rajonale të Transportit, Ministrinë e Brëndshme, Bankat, Dhomën e Tregtisë, Shoqatat e Bizneseve, etj., si dhe me administratat analoge jashtë vendit.

Drejtoria e Hetimit dhe Drejtoria e Investigimit të Brëndshëm (Antikorrupsion) të krijuara rishtazi, synojnë goditjen e krimit ekonomik dhe të fenomeneve të korrupsionit. Misioni i Drejtorisë së Hetimit Tatimor është ndjekja dhe zbatimi i legjislacionit penal në fushën e tatimeve dhe të taksave, me qëllim që të nxisë dhe të realizojë, direkt apo indirekt, përmbushjen e detyrimeve nga tatimpaguesit, sipas kërkesave të legjislacionit tatimor.

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është nën varësinë e Ministrit të Financave.

Agjencia ka për objekt kryesor të veprimtarisë së vet:

- Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim të Gjykatës për Krimet e Rënda, në zbatim të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”;

- Administrimin e pasurive të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;

- Agjencia ushtron veprimtarinë e saj në bashkëpunim me institucionet pjesëmarrëse në procesin e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si gjykatat, prokuroritë, bankat, strukturat e qeverisjes vendore si dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku ndodhen pasuritë e patundshme të sekuestruara dhe të konfiskuara. Një konfiskim civil që synon sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve që i përkasin personave të dyshuar për pjesëmarrje në aktivitete të krimit të organizuar si dhe të afërmeve të tyre apo personave që lidhen me ta.

- Sipas nenit 39 të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, ngrihet fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, i cili administrohet nga Ministri i Financave, mbështetur në evidencat e Komitetit Këshillues për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

- Agjencia është përgjegjëse për verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për kërkesat që lidhen me financimin e projekteve nga fondi i posaçëm, për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor si dhe ndjek zbatimin e tyre.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT

Është institucioni më i rëndësishëm potencial për sigurimin e rendit, për parandalimin dhe goditjen e krimit, për të garantuar paprekshmërinë e kufirit. Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” siguron zhvillimin e karrierës në polici, garanton të drejtat si dhe ngarkon me një sërë përgjegjësish, ndër të cilat parandalimi, zbulimi dhe hetimi i krimit, në përputhje me ligjin penal dhe procedural penal, të veprave penale dhe të autorëve të kryerjes së tyre.

Policia e Shtetit është e pajisur me një sërë instrumentash të tjerë ligjorë e nënligjorë për organizmin e punës gjurmuese policore, për përdorimin e teknikave speciale të hetimit, të teknikave investigative, kontrolleve, sekuestimeve, arrestimeve në flagrancë, kërkimin dhe një sërë veprimesh të tjera procedurale penale të atribuara me ligj dhe të deleguara nga organi i akuzës. Është autoriteti shtetëror më potencial njerëzor dhe teknik për zbatimin e ligjit.

Strukturat e Policisë së Shtetit janë riorganizuar në bazë të koncepteve bashkëkohore. Në nivel qëndror funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit e cila përbëhet nga Departamenti për Hetimin e Krimeve, Departamenti i Sigurisë Publike, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti për Trajnimin Policor, si dhe stuktura të tjera mbështetëse të personelit, Standarteve Profesionale, Buxhetit dhe Financës etj. Në nivel vendor funksionojnë drejtoritë e policisë së qarqeve, drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit, komisaritet, komisaritet e kufirit dhe migracionit, stacionet e policisë dhe stacionet e kufirit dhe të migracionit.

Drejtoria kundër Krimit Financiar, Drejtoria kundër Krimit të Organizuar; Drejtoria Kundër Krimeve të Rënda, Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Drejtësisë, Drejtoria e Analizës së Informacionit kriminal, Interpoli, Europoli, në Departamentin për Hetimin e Krimeve në nivel qëndror dhe me sektorët përkatës në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve janë struktura të përfshira dhe me rol vendimtar në hetimin e krimeve, përfshirë dhe krimin financiar, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Rëndësi të veçantë ka në këtë aspekt Drejtoria Kundër Krimit Financiar, e cila identifikon, zbulon, parandalon, godet dhe heton rastet e krimeve financiare, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, identifikon asetet që sigurohen nga krimet dhe vepron për sekuestrimin dhe konfiskimin e tyre.

SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR (SHISH);

Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) është institucion qëndror i sigurisë, që varet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe Presidenti i Republikës. Ai është krijuar sipas parimit të njohur që një vend ka nevojë për një organizëm efektiv, profesional dhe të aftë të furnizojë me inteligjencë organizmat dhe institucionet shtetërore të ngarkuara me Ligj, në funksion të sigurisë kombëtare.

Duke synuar përmbushjen e këtij detyrimi kushtetues dhe ruajtjen e Sigurisë dhe interesave kombëtare, politike dhe ekonomike, Shërbimi Informativ Shtetëror siguron inteligjencë jo vetëm brenda Shqipërisë, por dhe jashtë saj.

Shërbimi Informativ Shtetëror nuk kryen veprimtari të karakterit ushtarak ose policor. Ligjshmëria, objektiviteti dhe sekreti janë parimet bazë të punës së këtij organi. Organizimi i strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror përpunon me kërkesat e përmbushjes së misionit të tij, sidomos të ruajtjes së sigurisë kombëtare.

Sipas detyrave që ngarkon ligji bazë i Shërbimit Informativ Shtetëror, aktet e tjera ligjore kundër krimit të organizuar dhe prioritetet e qeverisë Shqipëtare, SHISH është i angazhuar edhe në drejtim të luftës kundër krimit financiar si edhe kundër pastrimit të parave që janë produkt i veprave kriminale të organizuara si dhe sidomos në drejtim të luftës kundër financimit të terrorizmit.

Pjesëmarrja dhe aderimi i Shqipërisë në proceset e integritetit në strukturat Euro Atlantike të sigurisë, roli i saj aktiv në planin Europian dhe rajonal si edhe përballja e saj me kërcënimet e sotme, si krimi i organizuar me të gjitha llojet e trafikëve, krimi financiar, pastrimi i parave, financimi i terrorizmit, etj., janë sfidat me të cilat duhet të ndeshet SHISH, së bashku me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

INSPEKTORIATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive ka filluar funksionimin në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

"Inspektorati i Lartë", nën përgjegjësinë e Inspektorit të Përgjithshëm, administron deklarimin e pasurisë, të detyrimeve financiare, ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kryen kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që mbartin detyrimin ligjor për deklarim të interesave private.

ILDKP bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe të krimit ekonomik.

BANKA E SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë është Banka Qëndrore e Republikës së Shqipërisë. Zhvillimet ekonomiko-politiko dhe shoqërore, që prej krijimit të saj e deri më sot, i kanë shtuar dhe zgjeruar funksionet e Bankës së Shqipërisë. Statusi i Bankës së Shqipërisë sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 8269, datë 27.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.

Banka e Shqipërisë është bankë me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët zgjidhen nga ana e Kuvendit të Shqipërisë për një periudhë 7-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Këshilli Mbikëqyrës kryesohet nga Guvernatori, i cili vepron edhe si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë, i ngarkuar për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të saj.

Brenda kompetencave të përcaktuara me ligj, Banka e Shqipërisë është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Çdo subjekt është i detyruar të respektojë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, të mos kërkojë të influencojë të ndonjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për të cënuar detyrimet e tij ndaj Bankës së Shqipërisë, si dhe të mos ndërhyjë në veprimtaritë e Bankës së Shqipërisë.

Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë gëzon funksionet e mëposhtme:

- Harton, miraton dhe zbaton politikën monetare të vendit, për realizimin e objektivave të së cilës ajo përdor instrumentet e duhura monetare;
- Ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare;
- Mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë;
- Harton, miraton dhe zbaton regjimin e këmbimit valutor si dhe politikën e kursit të këmbimit;
- Licencon ose revokon licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe mbikëqyr aktivitetin bankar me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar;
- Shërben si bankier, këshilltar e agjent fiskal i Republikës së Shqipërisë;
- Shërben si bankë e bankave të nivelit të dytë;
- Nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave.

AUTORITETI I MBIKQYRJES FINANCIARE

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare”, si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikqyrur tregjet financiare jo-bankare brënda vendit. AMF është institucion qëndror, i pavarur nga ekzekutivi dhe përgjigjet para Kuvendit të Shqipërisë.

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
- Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare;
- Sigurimi dhe respektimi i ligjit.

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë:

- Rregullimi dhe mbikqyrja e tregut të sigurimeve dhe veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- Tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg;
- Tregut të pensioneve suplementare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve suplementare, të ofruara nga institutet private;
- Veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës.

Funksionet bazë rregullative dhe mbikëqyrëse të AMF-së parashikohen kryesisht në nenet 2 dhe 13, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare” dhe pjesërisht në ligjet e sektorëve të mbikëqyrur.

Bordi i Autoritetit Mbikëqyrës Financiar është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, që përbëhet nga 7 anëtarë, 3 prej të cilëve janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë dhe kryejnë përkatësisht funksionet e kryetarit dhe dy nënkryetarëve. Të gjithë anëtarët e Bordit mandatohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

KAPITULLI III

BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL

Në zbatim të objektivave të kësaj strategjie dhe rritjes së efektivitetit të luftës kundër krimit ekonomik - financiar, është i domosdoshëm dhe i nevojshëm forcimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet: Ministrisë së Brëndshme, PP, DPT, DPD, DPPP, SHISH, ILDKP, AAPSK etj.

Një rëndësi të veçantë në këtë kuadër ka edhe bashkëpunimi me institucionet mbikëqyrëse si: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe grupet e interesit, si: Shoqata e Bankave të Shqipërisë, IEKR, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Avokatëve, Dhoma e Tregtisë etj.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Evoluimi i krimit ekonomik - financiar dhe natyra gjithnjë e më shumë trans-nacionale e tij e bën të nevojshme thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me partnerët dhe organizmat ndërkombëtarë.

INTERPOL

Interpoli është një organizatë policore ndërkombëtare, me 187 vende anëtare, krijuar që prej vitit 1923, me mision lehtësimin e bashkëpunimit policor në rrafshin ndërkombëtar si dhe mbështetjen e të gjitha organizatave, autoriteteve dhe shërbimeve që kanë për qëllim parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkombëtar.

EUROPOL

Europol është Agjencia Europiane e Inteligjencës Kriminale, e krijuar më 1 Korrik 1999, bazuar në marrëveshjen e Matrihtit, të vitit 1992. Agjencia është aktive në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe koordinon aktivitetet nga qendra e saj në Hagë.

Misioni i EUROPOLIT është të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në luftën kundër krimit të organizuar në Bashkimin Europian. Policia Shqiptare do të intensifikojë bashkëpunimin me këtë organizë

KOMITETI MONEYVAL

Shqipëria është anëtare që prej vitit 1998 e Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Këshillit të Europës. Komiteti luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e standarteve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në vlerësimet periodike të bazuara në standartet e FATF-së dhe BE-së, Komiteti u jep vendeve anëtare rekomandime të rëndësishme në fushën ligjore, financiare dhe atë të zbatimit të ligjit.

Grupi EGMONT

Grupi EGMONT është një rrjet i rëndësishëm ndërkombëtar i Njërive të Inteligjencës Financiare. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është anëtare me të drejta të plota që prej vitit 2003. Grupi EGMONT përbën një forum të rëndësishëm për shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira mes vendeve anëtare, si dhe rritjen e nivelit të zbatimit të standarteve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

GRUPI I VENDEVE KUNDËR KORRUPSIONIT (GRECO)

Këshilli i Europës ka krijuar një numër instrumentash për luftën kundër korrupsionit në fushën publike dhe atë private si dhe kompensimin e dëmeve që shkaktohen nga korrupsioni, sjellja e nëpunësve publikë dhe financimi i partive politike. Këto instrumente synojnë të përmirësojnë kapacitetet e shteteve për të luftuar korrupsionin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Vlerësimi dhe monitorimi i masave të marra në këtë drejtim nga vendet e Këshillit të Europës kryhet nga GRECO.

INICIATIVA E BASHKËPUNIMIT TË EUROPËS JUGLINDORE (SECI)

Iniciativa e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar është një grupim i administratave Policore dhe Doganore të trembëdhjetë vendeve të Evropës Juglindore, ndër të cilët bën pjesë dhe Shqipëria si vend themelues. Rezultatet e punës së Qendrës SECI në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar, kanë sjellë në mënyrë të natyrshme nevojën që kjo iniciative të zhvillohet më tej në një nivel më të lartë organizativ. Për këtë arsye,

nëpërmjet një grupi të posaçëm pune, është realizuar projekt - konventa e SELEC (Qendra e Zbatimit të Ligjit e Evropës Juglindore), një dokument, i cili është miratuar edhe nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit, organi më i lartë vendimmarrës i SECI-t. Me ratifikimin dhe hyrjen në fuqi të këtij dokumenti të së drejtës ndërkombëtare, iniciativa SECI do të shndërrohet në organizatë ndërkombëtare, një status i cili do të rrisë kapacitetet dhe performancën në luftën kundër krimit ndërkufitar.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

Bashkëpunimi rajonal është i rëndësishëm për zhvillimin e konsolidimin e hetimit të krimit ekonomik financiar. Dokumenti Strategjik Kombëtar përcakton objektiva si dhe aktivitete për të gjitha institucionet shtetërore.

KAPITULLI IV

BURIMET DHE ZBATIMI I STRATEGJISË SI DHE PLANI I VEPRIMIT

Zbatimi i dokumentit strategjik kombëtar “Për hetimin e krimit financiar” kërkon angazhimin e një sërë institucionesh shtetërore. Drejtimi dhe bashkërendimi gjatë të gjithë zbatimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar do të kryhet nga një Grup Teknik Ndër-Institucional, përbërja e të cilit përcaktohet nga Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave, i cili mbikëqyr veprimtarinë e këtij grupi.

BURIMET

Zbatimi i kësaj strategjie kërkon burime njerëzore, teknike, financiare dhe logjistike. Të gjitha institucionet e përfshira në kryerjen e aktiviteteve afatmesme dhe afatgjatë do të identifikojnë dhe do të përcaktojnë burimet përkatëse për zbatimin e tyre.

PERIUDHA E ZBATIMIT

Objektivat strategjikë dhe aktivitetet e përcaktuara në planin e veprimit do të zbatohen gjatë viteve 2009-2015. Gjatë kësaj periudhe, Komiteti Kombëtar për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave do të mbikëqyrë zbatimin dhe do të bëjë propozimet e nevojshme për t’ju përshtatur gjendjes aktuale apo zhvillimeve, të cilat mund të marrin përparësi në këtë hark kohor.

DOKUMENTET REFERUESE

Dokumentet e mëposhtëm janë përdorur si referencë për formulimin e kësaj strategjie:

- Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë;
- Raporti i vlerësimit të Tretë të Progresit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL i KE;
- Strategjia Kombëtare për Manaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plan-Veprimi;
- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve e Terrorizmit;
- Strategjia Kombëtare Antidrogë 2004-2010 dhe Plani i saj i Veprimit;
- Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore;
- Manuali i kryerjes së hetimeve financiare, i përgatitur nën projektin CARPO;
- Materiale, propozime e rekomandime në kuadër të projektit të binjakëzimit me Zyrën Kriminale Federale të Gjermanisë (BKA) “Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimeve financiare”.

Strategjia përkufizon qartë objektivat afatmesëm dhe afatgjatë dhe në të njëjtën kohë përcakton prioritetet dhe aktivitetet të cilat do të sigurojnë përmbushjen e tyre.

KAPITULLI IV – Plani i Veprimit

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRPP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
1	Hartimi dhe harmonizimi i legjislacionit me standartet ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtar.	1.1 Përafrimi i legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave me “ <i>Acquis Communautaire</i> ”	2011 - 2015	√	√	√	√	√*	√	√		√	√	√	√
		1.2 Përafrimi i legjislacionit në fushën e administrimit të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara me “ <i>Acquis Communautaire</i> ”	2009 - 2011	√*	√	√	√	√						√	
		1.3 Përafrimin e legjislacionit doganor Shqipëtar me legjislacionin e Komunitetit Evropian në fushën e zbatimit të ligjit si dhe me praktikën e tyre më të mira, me qëllim unifikimin e tyre.	2009 - 2011	√				√	√*						
		1.4 Harmonizimi i legjislacionit penal me “ <i>Acquis Communautaire</i> ” dhe konventat ndërkombëtare.	2009 - 2015	√*		√	√							√	

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRPP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
2	Rritja e efektivitetit të kontrollit, mbikqyrjes për zbatimin e legjislationit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	2.1 Vlerësimi në shkallë vendi i nivelit të rrezikut të pastrimit të parave.	2009 - 2011			√	√	√*	√	√	√		√		
		2.2 Fuqizimi i mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, nëpërmjet trajnimit të stafit të përfshirë në këtë proces.	2009 - 2011										√*		
		2.3 Diagnostikimi, dokumentimi dhe përmirësimi i procedurave të Kontrollit dhe Investigimit të subjekteve tregëtare.	2009-2015						√	√*					
		2.4 Zbatimi i programit të zgjedhjes së kompjuterizuar të subjekteve tregëtare bazuar në analizen e rrishtit.	2009-2012						√	√*					
		2.5 Reduktimi i mëtejshëm i përdorimit të parasë fizike në ekonomi me anë të zhvillimeve të mëtejshme ligjore dhe operacionale.	2009 - 2015	√	√		√		√	√			√*		
		2.6 Hartimi i procedurave të përbashkëta për analizen dhe hetimet financiare.	2009-2012			√*	√	√	√	√			√		√
		2.7 Krijimi i një grupi të përbashkët pune për parandalimin e krimit financiar në fushën bankare.	2009 - 2011					√					√*		

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRPP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
3	Rritja e nivelit profesional dhe kapaciteteve njerëzore të institucioneve shtetërore të përfshira në hetimin e krimit financiar	3.1 Trajnim i stafit në lidhje me procedurat e kontrollit brëndshëm.	2009 -2011					√	√	√*					
		3.2 Trajnimi i stafit për metodat e hetimit financiar, për të krijuar një trupë prokurorësh, hetuesish, ekspertësh financiar dhe auditues llogarish.	2009 - 2011			√*	√	√	√	√	√	√			
		3.3 Hartimi dhe implementimi i Planeve Vjetor të Trajnimeve, për të mundësuar ngritjen e aftësisë profesionale të stafit	2009 - 2011			√	√	√	√	√	√		√		
		3.4 Hartimi i Manualit të Burimeve Njerëzore dhe zbatimi i një programi elektronik për administrimin e të dhënave të personelit	2009 - 2011			√	√	√	√	√			√		
		3.5 Trainimi dhe çertifikimi i ekspertëve ligjor në fushën e kontabilitetit e financës (forensic accountants)	2009 - 2012					√*	√	√					

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRPP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
4	Evidentimi dhe dokumentimi më efektiv i hetimit të krimeve financiare	4.1 Krijimi i bazave të të dhënave në institucione për rastet e hetimeve financiare.	2009 -2011			√*	√	√	√	√	√				
		4.2 Trainimi i magjistrateve (prokurorë dhe gjykatës) me praktikat më të mira botërore të hetimit financiar.	2009-2012	√*		√									
		4.3 Krijimi i një baze të dhënash për shkëmbimin e praktikave më të mira në hetimin e krimit financiar mes institucioneve Shqipëtare	2009-2013			√	√	√	√*	√					
		4.4 Shkëmbimi në rrugë elektronike dhe i sigurtë i të dhënave mes institucioneve të zbatimit të ligjit për çështjet e hetimit financiar.	2009-2014			√	√*	√	√	√					
		4.5 Përmirësimi i vazhdueshëm i mbledhjes, ruajtjes, përpunimit dhe standartizimit të të dhënave statistikore për rastet e krimeve financiare dhe pastrimit të parave.	2009-2012			√	√	√*	√	√					

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRPP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
5	Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar	5.1 Nënshkrimi i protokolleve të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rishikimi i atyre eksistues.	2009 -2012			✓	✓*	✓	✓	✓	✓	✓		✓	
		5.2 Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të TI dhe dixhitalizimi i bazave të të dhënave dhe rregjistrave publike të institucioneve shtetërore.	2009 -2015	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓		✓	
		5.3 Aksesimi i bazave të të dhënave dhe rregjistrave publike të institucioneve shtetërore ndërmjet personave të kontaktit	2009-2011	✓	✓	✓	✓	✓*	✓	✓		✓	✓	✓	✓
		5.4 Rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare	2009 - 2015	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓			✓	✓	
		5.5 Pjesëmarrja në mbledhjet e grupit Egmont dhe shkëmbimi i praktikave më të mira me partnerët ndërkombëtar	2009 - 2015	✓		✓	✓	✓*					✓		
		5.6 Pjesëmarrjet në mbledhjet plenare të komitetit të ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	2009 - 2015	✓		✓	✓	✓*					✓		

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRPP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
6	Ndërgjegjësimi i publikut dhe i subjekteve raportuese për rëndësinë e luftës kundër krimit financiar si dhe rolit të institucioneve	6.1 Publikimet në media në fushën e luftës kundër krimit financiar.	2009 – 2015	√	√	√	√	√*	√	√		√	√	√	√
		6.2 Zbatimi i praktikave më të mira ndërkombëtare nga autoritetet mbikqyrëse në raportimin e transaksioneve të dyshimta prej subjekteve raportuese.	2009 – 2011	√					√	√			√*		√
		6.3 Botimet e manualeve dhe studimeve të përbashkëta në lidhje me krimin financiar, korrupsionin dhe efektet e tyre negative në shoqëri.	2009 – 2012	√	√	√	√	√*	√	√		√	√	√	√
		6.3 Hartimi i masave konkrete në bazë institucioni për njohjen e publikut me zhvillimet ligjore dhe proceduriale në fushën e hetimit të krimit financiar.	2009 – 2011	√		√*	√	√	√	√			√		
		6.4 Rritja e aksesit të publikut në faqet zyrtare të internetit të institucioneve si dhe zgjerimi i informacionit në lidhje me hetimin e krimit financiar.	2009 – 2011	√		√	√*	√	√	√			√		
		6.5 Bashkëpunimi në kryerjen e aktiviteteve të trajnimit për parandalimin të krimeve financiare në përgjithësi dhe pastrimit të parave e financimit të terrorizmit në veçanti.	2009 - 2015	√		√	√	√*	√	√			√		

Nr	Objekti	Aktivitetet	Periudha e Zbatimit	Ministria e Drejtësisë	ZQRP	PP	DPSH	DPPPP	DPD	DPT	SHISH	ILDKP	BSH	AAPSK	AMF
7	Forcimi i kapaciteteve parandaluese të Agjensive të zbatimit të ligjit dhe krijimi i mekanizmave adekuat për këtë qëllim.	7.1 Penalizimi i posedimit të aseteve të prejdardhura nga krimi e të pajustificuara dhe zbatimi i masave konkrete për konfiskimin e zgjeruar penal si dhe konfiskimn civil në përputhje me rekomandimin e III të Grupit të Veprimit Financiar (FATF) e praktikat më të mira europiane në këtë fushë.	2011 - 2014	√*		√	√								
		7.2 Krijimi i një zyre qendrore unike, (Asset Recovery Office) e cila do të bëjë në mënyrë aktive rregjistrimin e përditësuar si dhe do të ndjekë në vazhdimësi statusin e aseteve nga ngrirja e sekuestrimi deri në konfiskimin e tyre.	2009 - 2011	√		√	√							√*	
		7.3 Zgjerimi i numrit të veprave penale të cilat janë subjekt i konfiskimit të detyrueshëm e të zgjeruar.	2009 - 2013	√*		√									
		7.4 Krijimi i mekanizmave të rinj apo zhvillimi i atyre ekzistues për financimin e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe punonjësve të tyre nga të ardhurat që sigurohen nga konfiskimi i aseteve;	2010-2011	√		√*	√	√	√	√	√			√	

Shënim:

√ - Institucion i përfshirë në aktivitet.

√* - Institucion i përfshirë dhe koordinues i aktivitetit.

VENDIM
Nr.1081, datë 21.10.2009

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR TË
USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 pika 7, 64 pikat 2 e 5, e 65 pika 3 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 31.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONET E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT (AKU)

1. AKU-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm dhe mbikëqyret nga bordi i këtij autoriteti, i cili është përgjegjës për të siguruar që AKU-ja të kryejë misionin dhe të përmbushë detyrat e ngarkuara nga legjislacioni përkatës.

2. AKU-ja organizohet në Drejtorinë e Përgjithshme, në nivel qendror, dhe drejtoritë rajonale, në çdo qark të vendit.

3. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme funksionojnë komiteti shkencor dhe panelet shkencore.

4. Drejtoria e Përgjithshme ka këto funksione:

a) Planifikon dhe bashkërendon kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, të mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;

b) Siguron unifikimin e praktikave të kontrollit të sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, të mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, në shkallë vendi;

c) Bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të autorizuar të sistemit të kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;

ç) Siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e autorizuar të kontrollit zyrtar të ushqimit;

d) Drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;

dh) Kryen studime shkencore të nevojshme për vlerësimin e riskut në fushën e sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;

e) Përgatit mendimin shkencor paraprak për nxjerrjen në treg të OMGJ-ve dhe/ose ushqimeve të reja;

ë) Informon publikun për fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;

f) Jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore, për të siguruar veprimtarinë e komitetit shkencor dhe të paneleve shkencore;

g) Përgatit raportin vjetor për vlerësimin e funksionimit të AKU-së;

gj) Përgatit planin e punës e buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm të AKU-së, që miratohet nga bordi.

5. Drejtoritë rajonale të AKU-së drejtohen nga drejtori rajonal dhe kryejnë këto funksione:

a) Kryejnë kontrollet paraprake për të vërtetuar nëse janë plotësuar kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve;

b) Kryejnë kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, si dhe në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe të mbrojtjes së shëndetit të kafshëve në territorin e qarkut përkatës;

c) Kryejnë kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve në njësitë e inspektimit kufitar;

ç) Kryejnë mbledhjen e informacionit në fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve dhe përcjelljen e tij në Drejtorinë e Përgjithshme;

d) Ndalojnë, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, veprimtarinë e operatorëve të biznesit të ushqimit dhe të atij të ushqimit për kafshë në fazat e prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe tregtimit të ushqimit apo ushqimit për kafshë, kur vërtetohet se ushqimi a ushqimi për kafshë dhe operatorët përkatës të biznesit nuk plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

dh) Përgatisin raportin vjetor për vlerësimin e funksionimit të drejtorisë rajonale të AKU-së.

6. Pikat e inspektimit kufitar janë pjesë administrative e drejtorive rajonale përkatëse të AKU-së dhe kryejnë kontrollin e ngarkesave të kafshëve të gjalla, bimëve dhe produkteve, që origjinojnë prej tyre, të cilat hyjnë, dalin ose tranzitojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. Laboratorët rajonalë janë pjesë administrative e drejtorive rajonale përkatëse të AKU-së. Në to kryhet analizimi laboratorik për kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe bimëve.

8. Drejtoritë rajonale ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, punonjës të drejtorisë rajonale mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale përkatëse, që mbulon territorin e atij qarku.

II. KRITERET E EMËRIMIT, TË SHKARKIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË AKU-SË, SI DHE TË DREJTAT, DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I BORDIT

1. Përbërja e bordit dhe zgjedhja e kryetarit përcaktohen në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”.

2. Anëtar i bordit zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) Të ketë arsim të lartë në drejtësi, ekonomi ose në shkencat teknike, që lidhen me fushat, ku gjen zbatim ligji i ushqimit;

c) Përfaqësuesit e ministrive të linjës të kenë përvojë pune në administratën shtetërore, të paktën 5 vjet, ndërsa përfaqësuesit, që emërohen sipas shkronjave “dh”, “ë”, “f” dhe “g”, të nenit 64 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të jenë personalitete të shquara të fushave, ku ata veprojnë;

ç) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

d) Të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore;

dh) Të mos jetë në konflikt interesi me detyrat, funksionet apo veprimtarinë e vet shtetërore apo private.

3. Bordi i AKU-së mbikëqyr veprimtarinë e këtij autoriteti dhe i raporton Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Bordi, nëpërmjet anëtarëve të tij, ndihmon, gjithashtu, në bashkërendimin e punës me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera, të përfaqësuara në bord.

5. Bordi ka këto të drejta dhe detyra:

a) Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të AKU-së;

b) Miraton objektivat strategjike dhe planet e punës të AKU-së;

c) Miraton projektbuxhetin e AKU-së, që i paraqitet Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

ç) Miraton raportin vjetor të vlerësimit të veprimtarisë së AKU-së;

d) Miraton kërkesat e posaçme të vendeve të punës për rekrutimin e punonjësve të AKU-së;

dh) Miraton projektplanin e menaxhimit të krizave, të propozuar nga AKU-ja.

6. Anëtarët e bordit, përfaqësues të ministrive, duhet të jenë punonjës në ministrinë përkatëse dhe emrat e tyre i propozohen Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nga ministri përkatës. Emrat e anëtarëve të bordit sipas shkronjave “dh”, “ë”, “f” dhe “g”, të nenit 64 të ligjit, caktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë,

Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bazë të kandidaturave të paraqitura, përkatësisht, nga organet përkatëse, të cilat, për çdo anëtar, paraqesin një listë me jo më pak se dy kandidatë.

7. Anëtarët e bordit shkarkohen nga kjo detyrë dhe mandati i tyre përfundon, kur Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit vëren se:

a) anëtar i bordit, përfaqësues i një ministrie linje, nuk është më në marrëdhënie pune me këtë ministri;

b) anëtar i bordit, sipas shkronjës “ë” të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, nuk është më në marrëdhënie pune me universitetin përkatës;

c) detyra si anëtar i bordit është në konflikt interesi me detyrën, veprimtarinë apo funksionin që ky anëtar ka në sektorin shtetëror apo privat;

ç) ai i shmanget përgjegjësisë së funksionit si anëtar i bordit.

8. Mandati i anëtarëve, i caktuar sipas pikës “e” të nenit 64 të ligjit, përfundon para kohe, vetëm në rast zëvendësimi të kryetarit të shoqatës së bashkive. Në këtë rast, anëtar bëhet automatikisht kryetari i ri.

9. Përveç sa parashikohet më sipër, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ua ndërpret mandatin anëtarëve të bordit, nëse këta të fundit nuk marrin pjesë në asnjë nga mbledhjet e bordit për një periudhë vijuese 6-mujore. Organet propozuese propozojnë një anëtar të ri, sipas procedurave të sipërpërmendura.

10. Bordi i AKU-së mblidhet të paktën 1 herë në 3 muaj, dhe, në raste të veçanta, me kërkesë të drejtorit të përgjithshëm të AKU-së.

11. Anëtarët e bordit shpërblehen në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje, ku marrin pjesë. Shpërblimi për anëtarët e bordit përballohet nga buxheti i AKU-së.

12. Bordi i AKU-së organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës publike”.

III. EMËRIMI, SHKARKIMI DHE KOMPETENCAT E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

1. Drejtori i përgjithshëm i AKU-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas procedurave të parashikuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

2. Drejtor i përgjithshëm zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë arsimin e lartë në drejtësi, ekonomi ose shkenca teknike, që lidhen me fushat, ku gjen zbatim ligji i ushqimit.

b) Të ketë përvojë pune në administratën shtetërore, të paktën 5 vjet.

c) Të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale.

ç) Të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

d) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale.

3. Drejtori i përgjithshëm i AKU-së është përgjegjës për veprimtarinë e këtij autoriteti dhe, përveç sa parashikohet në ligj, ka këto kompetenca:

a) I raporton bordit dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për veprimtarinë e AKU-së;

b) I propozon bordit objektivat strategjike, planin e punës dhe buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm të AKU-së;

c) Drejton procesin e planifikimit buxhetor dhe të raportit vjetor të punës, të cilat ia paraqet për vlerësim bordit;

ç) Përcakton objektivat e përgjithshëm të AKU-së, në përputhje me objektivat strategjike, të miratuara nga bordi, dhe harton planin vjetor të punës së këtij autoriteti;

d) I propozon bordit rregulloren e brendshme të AKU-së dhe ndryshimet në të;

dh) Administron burimet pasurore, financiare dhe njerëzore të AKU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Përgatit kërkesat e veçanta të vendit të punës për rekrutimin e punonjësve të AKU-së, të cilat ia paraqet për miratim bordit;

ë) Merret me trajnimin e punonjësve të AKU-së;

f) Autorizon shpërndarjen e informacionit për publikun.

4. Drejtori i përgjithshëm i AKU-së, për realizimin e kompetencave të mësipërme, ka këto të drejta dhe detyra:

a) Nxjerr akte të brendshme, të detyrueshme për menaxhimin administrativ, financiar dhe të burimeve njerëzore të institucionit;

b) Nxjerr akte të detyrueshme për punonjësit e AKU-së për realizimin e funksioneve të institucionit;

c) Nxjerr akte të brendshme individuale, për rregullimin e marrëdhënieve të punës së punonjësve dhe të punonjësve të AKU-së;

ç) Nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera publike shqiptare apo të huaja, pas miratimit paraprak të bordit;

d) Kërkon thirrjen e mbledhjeve të bordit sipas pikës 10 të kreut II të këtij vendimi, dhe merr pjesë në to;

dh) Autorizon me shkrim një nga drejtorët për ta zëvendësuar për problemet administrative, në rast të mungesës së tij;

e) Shqyrton ankimet ndaj vendimeve të inspektorëve të kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, për të cilat kthen përgjigje brenda afateve të parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

IV. MARRËDHËNIET E PUNËS TË PUNONJËSVE TË AKU-SË

1. Struktura dhe organika e AKU-së në qendër dhe në qark miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të drejtorive rajonale të AKU-së bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

3. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të AKU-së rregullohen sipas ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.

V. STEMA DHE VULA ZYRTARE E AKU-SË

1. AKU-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e AKU-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit”.

3. Vulat e AKU-së kanë formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme përmban shënimin identifikues “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme”, ndërsa vulat e drejtorive rajonale përmbajnë shënimin identifikues: “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, drejtoria rajonale e qarkut: (emri përkatës i qarkut)”.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Organizimi i AKU-së, deri në funksionimin e plotë të tij, të kryhet me faza. Procesi i organizimit fillon me emërimin e drejtorit të përgjithshëm.

2. Faza e parë përfshin një periudhë katërmujore, gjatë së cilës kryhet emërimi i drejtorit të përgjithshëm dhe bordit, si dhe rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së. Gjithashtu, në këtë fazë përgatitet plani i veprimit dhe krijimi i kushteve për ngritjen dhe funksionimin e drejtorive rajonale të AKU-së.

3. Faza e dytë përfshin periudhën nga muaji i pestë deri në muajin e dymbëdhjetë, gjatë së cilës emërohen drejtorët e drejtorive rajonale të AKU-së, rekrutohen punonjësit e tyre, si dhe sigurohen mjediset e nevojshme të punës. Deri në përfundim të kësaj faze, të gjitha drejtoritë rajonale përgatiten për fillimin e veprimtarisë së tyre në fushën e kontrollit të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet strukturave përkatëse, krahas detyrave të saj të përhershme për përgatitjen e legjislacionit, hartimin e politikave dhe menaxhimin e riskut, do të vazhdojë të ushtrojë, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Brendshme, të gjitha funksionet në fushën e sigurisë ushqimore, përfshirë edhe inspektimet, deri në plotësimin e masave të parashikuara për fazën e parë dhe të dytë.

5. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me urdhër, njofton fillimin e veprimtarisë së AKU-së, në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Pas këtij njoftimi, funksionet në fushën e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, të kryera nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe të Ministrisë së Brendshme (bashki dhe komuna), i transferohen AKU-së.

6. Faza e tretë përfshin një periudhë njëvjeçare nga muaji i trembëdhjetë deri në muajin e njëzet e katërt. Gjatë kësaj faze ndërmerren të gjitha veprimet përgatitore dhe kryhet transferimi i funksioneve në fushën e kontrollit të shëndetit të kafshëve dhe të mbrojtjes së bimëve, nga strukturat ekzistuese të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, tek AKU-ja.

7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet strukturave përkatëse, krahas detyrave të saj të përhershme për përgatitjen e legjislacionit, hartimin e politikave dhe menaxhimin e riskut, do të vazhdojë të ushtrojë të gjitha funksionet në fushën e kontrollit të shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, deri në plotësimin e masave të parashikuara për fazën e tretë.

8. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me urdhër, njofton fillimin e veprimtarisë së AKU-së në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e kontrollit të shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve. Pas këtij njoftimi, funksionet në fushën e kontrollit të shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, të kryera nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i transferohen AKU-së.

9. Të gjitha mjediset, pajisjet dhe pajisjet laboratorike në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, të cilat përdoren nga Inspektorati i Sigurisë Ushqimore, i Mbrojtjes së Bimëve dhe i Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve transferohen në administrim të AKU-së, në përputhje me fazat e mësipërme.

10. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe AKU-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1084, datë 28.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS ZALL-BASTAR TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zall-Bastar të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprahe, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zall-Bastar të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1488, datë 12.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zall-Bastar të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zall-Bastar për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Zall-Bastar

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
17,18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
19-57	Varreza publike	Në pronësi
59-139	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
235-290	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
713-721	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.1085, datë 28.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS OROSH TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Orosh të qarkut të Lezhës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 942 (nëntëqind e dyzet e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Orosh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Orosh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
22-31, 931	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
19	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
21, 851	Prona që përdoren në realizimin e programeve sportive dhe kulturore	Në pronësi
32-40	Varrezat publike	Në pronësi
46, 858-867, 869-884	Infrastrukturë vendore (rrugë, lulishte, trotuar, sheshe)	Në pronësi
41, 42	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
755-758, 763-766, 771, 772, 777-780, 785-787, 792-794, 799-801, 806-808, 812-814, 818-820, 825-827, 831-833, 837-839, 843, 844	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore).	Në përdorim
759-762, 767-770, 773-776, 781-784, 788-791, 795-798, 802-805, 809-811, 815-817, 821-824, 828-830, 834-836, 840-842, 845, 846-850	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore, kanale të treta).	Në pronësi
857	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
885-891	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1086, datë 28.10.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË LIBRAZHD TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Librazhd të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 422 (katërqind e njëzet e dy).

2. Ngarkohen Mministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Librazhd

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
9-15, 103, 354-363,366	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
26-49	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
50-53,104-110	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
72,74	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
374,375	Shërbim funeral	Në pronësi
370,371	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
348-351, 367, 368, 369, 372, 418-422	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
111-113	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
114-138	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
373	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi

VENDIM
Nr.80, datë 23. 10. 2009

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TE KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA (FPSH) DHE PRODHUESVE TË VEGJËL TË
ENERGJISË (PVE)**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.13 germa “a” pika 5, të modelit të tregut të energjisë elektrike, pikës “V” të rregullave të tregut shqiptar të energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, nenit 25 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, pasi shqyrtoi modelin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE)”, të paraqitur nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Modelit të Kontratës së Shitblerjes së Energjisë Elektrike, ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE). (Kontrata bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Çdo kontratë e lidhur midis KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të jetë në fuqi deri në momentin e përfundimit të afatit të saj.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KONTRATË
PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA DHE PRODHUESVE
TË VEGJËL TË ENERGJISË ELEKTRIKE

E lidhur sot më datë ____ / ____ 20 në Tiranë, ndërmjet;

Shoqërisë _____, person juridik shqiptar, regjistruar në _____ me vendim nr. _____ me nr. NIPT-i _____ me seli të shoqërisë _____, këtu e më poshtë e quajtur “Shitësi”, përfaqësuar nga znj/z _____;

dhe

Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a. (Furnizuesi publik me shumicë), person juridik shqiptar, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendim nr.12728, datë 6.11.1995, me seli të shoqërisë në bllokun “Vasil Shanto” Tiranë, këtu e më poshtë e quajtur “Blerësi”, përfaqësuar nga znj/z _____;

Duke qenë se:

-Shoqëria _____, ka marrë me koncesion/ ka privatizuar, HEC-in/et _____, sipas marrëveshjes së koncesionit/sipas kontratës së shitblerjes _____;

-Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate;

-ERE me vendim të saj nr. _____, datë _____, ka licencuar shoqërinë _____ për prodhimin e energjisë elektrike;

-KESH sh.a. duhet të nënshkruajë një kontratë për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike në zbatim të marrëveshjes koncesionare _____ /, ligjit nr.9470, datë 2.2.2006 “Për një shtesë në ligjin nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”;

-ERE ka autoritetin të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit e vegjël të energjisë.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 Përkufizime

Në këtë kontratë termat e mëposhtëm do të kenë kuptim si vijon:

Çmimi – do të thotë çmimi i shitblerjes së energjisë elektrike, i vendosur nga Enti rregullator i Energjisë sipas legjislacionit në fuqi.

Dita – do të thotë një periudhë kohore prej 24 orësh e cila fillon në orën 00.00 deri në 24.00.

Energjia elektrike ose energjia – nënkupton energjinë elektrike aktive dhe energjinë elektrike reaktive të transmetuar dhe të shpërndarë nga sistemi elektro-energjetik.

Energji elektrike aktive - është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës. Njësia matëse e saj është vat-orë ose shumëfisha të saj.

Energji elektrike reaktive – është integrali i caktuar me kufij kohe i fuqisë reaktive matur në njësi me volt- amper reaktive-orë ose shumëfisha të saj.

ERE – Enti Rregullator i Energjisë.

Frekuenca – numri i cikleve alternative të rrymës për sekondë, në të cilin funksionon sistemi elektroenergjetik;

“Forcë madhore” – është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë palën/palët kontraktuese të përmbushin detyrimet përkatëse sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palës/palëve dhe nuk ndodhin për faj të tij/tyre dhe pala/palët nuk është/janë në gjendje t'i eliminojnë ato, edhe pse ka/në ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij/tyre.

Defektet në pajisjet ose materialet ose vonesat për t'i bërë ato të disponueshme, konfliktet e punës, grevat ose problemet financiare nuk mund të kërkojnë të konsiderohen nga palët si forcë madhore, përveç rastit ku burojnë nga një rrethanë e lidhur me forcën madhore.

Furnizues publik me shumicë ose FPSH – është personi i licencuar për blerjen e energjisë elektrike nga gjenerimi publik, nga PPE-të, PVE-të apo treguesit për shitjen te furnizuesi publik me pakicë.

Kontrata – kjo kontratë e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike, e lidhur midis prodhuesit të vogël të energjisë PVE (shitësit) dhe KESH (Furnizuesit publik me shumicë) FPSH (Blerësit), si dhe çdo shtesë apo amendim që mund t'i bëhet asaj në të ardhmen.

Ligj – Ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar.

Matës- d.m.th. një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të energjisë elektrike.

Marrëveshje tregu – një marrëveshje, e cila përmban rregullat e tregtisë dhe përgjegjësitë e palëve në marrëveshje sipas legjislacionit në fuqi.

Muaji – do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00.00 p.d. të ditës së parë kalendarike të muajit dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit kalendarike të apo atij muaji.

Operator i sistemit të shpërndarjes – është personi juridik i licencuar, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Palë - Shitësi dhe Blerësi në këtë kontratë.

Pikë livrimi – Për efekt të kësaj kontrate, pika e livrimit do të jetë në zbarat dalëse të tensionit të mesëm të kabinës, apo të nënstacionit të impiantit prodhues.

Pikë matje – është pika e livrimit në të cilën sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas kodit të matjes së energjisë elektrike dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim.

Prodhues i vogël i energjisë elektrike/PVE ose prodhues – do të thotë një person juridik i licencuar për të prodhuar energji elektrike të lidhur me sistemin e shpërndarjes sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Sistemi i matjes së energjisë elektrike ose sistemi i matjes – është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e rrymës, mbrojtje e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore, të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në objekt.

Viti – do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00.00 të ditës së parë të vitit kalendarik dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit të po atij viti kalendarik.

Neni 2

Qëllimi i kontratës

2.1 Kjo kontratë përcakton termat dhe kushtet në të cilat blerësi do të jetë i detyruar të blejë, dhe shitësi do të jetë i detyruar të shesë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga shitësi si prodhues i vogël i energjisë elektrike, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim.

Neni 3

Livrimi, pranimi dhe transferimi i të drejtave

3.1 Shitësi, në përputhje me këtë kontratë duhet të programojë, të prodhojë e të shesë dhe blerësi duhet të programojë, të pranojë dhe të blejë të gjithë sasinë e prodhuar të energjisë elektrike në pikën e livrimit.

3.2 Shitësi është i detyruar të marrë masat e duhura të lidhë impiantin prodhues të energjisë elektrike me pikën e lidhjes të përcaktuar, sipas specifikimeve dhe rregullave të përcaktuara në kodin e shpërndarjes, kodin e matjes dhe akteve të tjera.

3.3 Energjia elektrike do të transmetohet nga shitësi tek blerësi në pikën e livrimit, ku dhe pronësia e energjisë do të kalojë nga shitësi tek blerësi.

3.4 Blerësi do t'i paguajë shitësit sasinë e blerë të energjisë elektrike me çmimin e kontratës dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 8 (faturimi dhe pagesa).

3.5 Blerësi bie dakord që të pranojë sasi të tjera shitesë të energjisë elektrike nga ana e shitësit, në rast të një prodhimi më të madh nga ky i fundit. Për këtë shitësi duhet të bëjë njoftimet përkatëse për t'i mundësuar blerësit marrjen e energjisë, si dhe rregullimin e programit të tij.

Neni 4

Dokumentacioni paraprak, tensioni, frekuenca

4.1 Shitësi do t'i verë në dispozicion/dorëzohë blerësit të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat lidhur me testimet dhe transmetimin e energjisë, specifikimet teknike të gjithë pajisjeve elektrike të instaluar, përfshirë këtu edhe certifikatat e specifikimeve, detajet e matësve dhe pajisjeve të sigurisë të instaluar, 30 ditë përpara se impianti prodhues të vihet në shfrytëzim të plotë e të fillojë prodhim/livrimin e energjisë.

4.2 Energjia elektrike duhet të livrohet me tension dhe frekuencë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Programet e livrimit

5.1 Impiantet prodhuese me fuqi të instaluar mbi 5 MW duhet të programojnë dhe të paraqesin tek blerësi programet e livrimit, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

5.2 Impiantet prodhuese me fuqi nën 5 MW do të paraqesin programin mujor/vjetor sipas sasisë së energjisë elektrike që parashikohet të prodhohet.

5.3 Devijimet nga programet e paraqitura do të trajtohen në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike apo çdo akti tjetër të miratuar nga ERE për këtë qëllim.

Neni 6

Matja e energjisë elektrike të livruar

6.1 Palët në këtë kontratë do të sigurojnë njëra-tjetrën se livrimet dhe pranimi i energjisë elektrike do të maten ose verifikohen me sistem matjeje, në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara në kodin e funksionimit të shpërndarjes dhe kodin e matjes së energjisë elektrike.

6.2 Matja e energjisë elektrike të livruar nga shitësi te blerësi do të kryhet në pikën e matjes/livrimit, e cila do të jetë në pronësi të shitësit, konform rregullave të përcaktuara në kodin e matjes së energjisë elektrike. Për përcaktimin e instalimit, mirëmbajtjes, kontrollit, testimit dhe vulosjes së sistemit të matjes së energjisë elektrike, palët i referohen kodit të matjes së energjisë elektrike.

6.3 Matësi kontrollohet, kolaudohet dhe vuloset në prezencë të personave të autorizuar të shitësit, blerësit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes. Kolaudimi kryhet në vende të autorizuar dhe certifikuar sipas kodit të matjes së energjisë.

6.4 Në ditën e caktuar nga palët në kontratë (ose në ditën e fundit të muajit përkatës), përfaqësuesit e autorizuar të shitësit dhe blerësit do të takohen për të lexuar aparatit matës të energjisë elektrike, që përcakton sasinë mujore të energjisë së livruar nga shitësi te blerësi çdo muaji. Tregimi i numërorit të matësit do të lexohet dhe regjistrohet çdo muaj për të realizuar kryerjen e bilancit të shitblerjes së energjisë elektrike. Në rast të mosfunksionimit të sistemit të matjes për shkak të defekteve, marrja e të dhënave do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve duke iu referuar regjistrave të leximit të matjes.

6.5 Për leximin e matjes të realizuar sipas pikës 6.3 të këtij neni, do të mbahet një procesverbal (aktrakordim) i leximit të aparatit matës, që do të firmoset nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve që kryejnë leximin, me përmbajtjen si më poshtë:

- a) Të dhënat e sistemit të matjes (aparati matës dhe transformatorët e matjes);
- b) Identitetin e personave që bëjnë leximin;
- c) Nënshkrimin e personave;
- d) Leximin e matësit për muajin paraardhës;
- e) Leximin aktual të matësit.

6.6 Në rastet kur përfaqësuesi i blerësit nuk paraqitet në datën e caktuar, shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do t'i dërgojë blerësit faturën. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në muajt e ardhshëm.

6.7 Blerësi duhet të mbajë në impiantet/instalimet përkatëse të prodhimit të energjisë regjistrin (manual) të leximit të matësit, i cili duhet t'i vihet në dispozicion për inspekte/testime përfaqësuesve të autorizuar të blerësit dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut që kanë akses ligjor.

6.8 Në çdo rast përfaqësuesit e autorizuar të furnizuesit publik me shumicë, në bazë të kodit të matjes dhe me cilësinë e blerësit të energjisë, mund të kryejnë inspekte dhe testime të sistemit të matjes dhe sistemet e tyre të regjistrimit. Punonjësi i impiantit përkatës do t'i vejë në dispozicion përfaqësuesve të FPSH regjistrin e leximit të matësit të energjisë elektrike dhe do t'i kryejë aksesin e nevojshëm për të kontrolluar sistemin e matjes.

6.9 Mbas instalimit të sistemit të matjes dhe regjistrimit të të dhënave online, shitësi është i detyruar të bëjë transmetimin e këtyre të dhënave, sipas këtij sistemi, përveç rasteve të pamundësive teknike për montimin e sistemit online të matjes.

Neni 7

Dokumentimi i procesit të livrimit/pranimit dhe matjes

7.1 Sipas një kërkesë të arsyeshme, palët:

a) do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton sasitë, livrimet dhe pranimet e energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës dhe shkakut të çdo devijimi nga programet;

b) do të kërkojnë nga operatori i sistemit të shpërndarjes dhe do të ndajnë mes tyre çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të verifikuar mospërputhjet mes flukseve të programuara dhe reale të energjisë elektrike.

7.2 Nëse njëra palë, me kërkesë të palës tjetër, ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga pala tjetër, kryen shpenzime të arsyeshme të jashtme, për të verifikuar nëse pala tjetër ka dështuar të përmbushë siç duhet detyrimet e saj sipas termave të kësaj kontrate, këto shpenzime do të rimbursohen nga pala që nuk ka përmbushur detyrimet, nëse kjo kërkohet.

Neni 8

Faturimi dhe pagesa

8.1 Fatura; Shitësi do t'i dorëzojë blerësit për livrimin e energjisë elektrike një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasitë totale të energjisë elektrike të shitur prej tij në muajin kalendarik paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën e pasardhëse të punës). Krahas faturës, shitësi do t'i dorëzojë blerësit edhe aktrakordin përkatës të mbajtur me përfaqësuesit e operatorit të sistemit të shpërndarjes.

8.2 Pagesa; Blerësi do t'i kryejë pagesën shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës nga blerësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e blerësit preken fondet monetare.

8.3 Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonësës, konsiston në pagimin e kamatëvonesës në masën e normës së interesit të bonove të thesarit me maturim 1- vjeçar +0.5% në vit për çdo ditë vonese të llogaritura nga data në të cilën do të kryhej pagesa. Kamatëvonesa paguhet pa qenë i detyruar kreditori (shitësi) të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

8.4 Shumat e diskutueshme; Për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga shitësi ose blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

Neni 9

Detyrimet mbi taksat dhe tatimet

9.1 Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrime që lidhen me të gjitha tarifatat, taksat, tatimet sipas legjislacionit në fuqi.

9.2 Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi në ose/dhe para pikës së livrimit dhe blerësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi pas pikës së livrimit.

Neni 10

Risku dhe humbja

10.1 Palët në fillim të çdo viti do të hartojnë dhe do të koordinojnë programet e remonteve të planifikuara, si dhe shërbimet për centralin dhe të linjave dhe pajisjeve elektrike të sistemit të shpërndarjes.

10.2 Shitësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me programimin, transmetimin dhe livrimin e sasisë së energjisë elektrike të kontraktuar deri në pikën e livrimit, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe akteve të tjera në fuqi, përveç rastit kur livrimi i energjisë është i pamundur si rezultat i rrethanave që nuk varen nga shitësi ose në rast se moslivrimi justifikohet nga riparimet vjetore dhe mirëmbajtjes sipas pikës 1 të këtij neni.

10.3 Blerësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me pranimin dhe transmetimin e sasisë së kontraktuar pas pikës së livrimit, përveç rastit kur moslivrimi i energjisë është i pamundur, si rezultat i rrethanave që nuk varen nga blerësi (forcë madhore) ose në rast se moslivrimi justifikohet nga avaritë në linjat dhe pajisjet elektrike të operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Neni 11

Çmimi

11.1 Blerësi paguan shitësin për energjinë elektrike të blerë, me çmimin e miratuar, nga ERE.

11.2 Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj kontrate është çmimi në fuqi i miratuar nga ERE.

11.3 Nëse ERE miraton një çmim të ndryshëm nga ai i aplikuar sipas paragrafit 11.2 palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasi të faturuara në përputhje me vendimin përkatës së ERE-s.

Neni 12

Forca madhore

12.1 Në qoftë se secila palë përballlet me forcën madhore, ajo do të njoftojë palën tjetër pa vonesë nëpërmjet një njoftimi me shkrim të konfirmuar si e marrë nga pala tjetër, duke i bërë të qartë kësaj të fundit natyrën e ngjarjes, kohëzgjatjen e mundshme dhe pasojat e pritshme.

12.2 Asnjëra palë nuk do të konsiderohet përgjegjëse për mospërbushje të detyrimeve kontraktore, në qoftë se ajo ka qenë penguar për realizimin e tyre nga forca madhore.

12.3 Palët do të ndërmarrin masat e nevojshme për të reduktuar minimalisht dëmet.

Neni 13

Kompensimet për mospranimin e energjisë elektrike

13.1 Kur blerësi nuk përmbush detyrimin për të pranuar energji nga shitësi sipas kësaj kontrate, dhe kur një mospërbushje e tillë nuk justifikohet nga një rast i forcës madhore, atëherë blerësi duhet të kompensojë shitësin për dëmin financiar të shkaktuar, të barabartë me produktin sasisë së energjisë të papranuar me çmimin e rregulluar nga ERE, në fuqi.

13.2 Shuma e paguar në përputhje me këtë nen, do të faturohet dhe paguhet sipas nenit 9 (faturimi dhe pagesa).

13.3 Asnjëra nga palët nuk do të jetë e detyruar të kompensojë humbjet e palës tjetër si rezultat i riparimeve apo mirëmbajtjes (përfshirë këtu edhe riparimet e urgjencës) të realizuara në përputhje me programin e rënë dakord nga palët.

Neni 14

Përfundimi i kontratës

14.1 Palët kanë të drejtë të përfundojnë kontratën, në qoftë se reciprokisht bien dakord për këtë gjë. Palët njoftojnë ERE-n brenda 5 ditësh për përfundimin e kontratës.

14.2 Në qoftë se gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës secila Palë vëren një shkelje serioze të detyrimit kontraktor nga ana e palës tjetër, menjëherë do ta njoftojë këtë të fundit me shkrim lidhur me këtë.

14.3 Pala tjetër brenda një afati kohor prej 10 ditësh nga marrja e njoftimit duhet të ndreqë ose kompensojë shkeljen e pretenduar të detyrimit kontraktor ose në rast të mospajtit lidhur me pretendimin do t'i shprehë palës tjetër me shkrim këtë mospajtim duke përcaktuar në të edhe argumentimet e veta për këtë.

14.4 Në qoftë se brenda afatit 10-ditor si më sipër nuk është bërë ndreqja apo kompensimi i shkeljes kontraktore ose pala që ka bërë shkeljen nuk i ka shprehur palës tjetër mospajtimin me shkrim brenda këtij afati, atëherë pala që pretendon shkeljen mund të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës.

14.5 Palët do të kenë të drejtë të kërkojnë përfundimin e kontratës në mënyrë të njëanshme, në qoftë se ato nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet kontraktore sipas kësaj kontrate për një periudhë kohore pa ndërprerje më shumë se 6 muaj si rezultat i forcës madhore.

14.6 Palët kanë të drejtë të kërkojnë përfundimin e kontratës kur:

a) Njëra nga palët falimenton ose nuk është në gjendje të paguajë borxhet ose dështon, ose pranon me shkrim paaftësinë e saj të përgjithshme për të paguar borxhet kur duhet;

b) në rast se njëra nga Palët ka dhënë garanci jokorrekte dhe të pavërteta;

c) në rast të shkeljes nga ana e palëve të rregullave dhe kërkesave teknike të parashikuara nga aktet nënligjore në fuqi.

14.7 Përfundimi i kontratës sipas paragrafëve 14.4,14.5,14.6 të këtij neni bëhet me miratimin e ERE-s.

14.8 Palët do të llogarisin brenda 30 ditëve pune duke filluar nga dita e përfundimit të kontratës, detyrimet financiare respektive dhe mënyrat e shlyerjes së tyre.

Neni 15

Afati i kontratës

15.1 Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare.

Neni 16

Hyrja në fuqi

16.1 Kjo kontratë, dispozitat e të cilës janë miratuar nga ERE hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 17

Ndryshimet

17.1 Në qoftë se ndonjë term, kusht apo rregull i kësaj kontrate do të bëhet i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm plotësisht apo deri në njëfarë mase, ky term, kusht apo rregull nuk do të sjellë pavlefshmërinë, paligjshmërinë apo pazbatueshmërinë e kushteve, termave dhe rregullave të parashikuara në pjesën tjetër të kësaj kontrate.

Neni 18

Legjislacioni

18.1 Kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike do të bazohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

Njoftimet

19.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

19.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1 Në rast të mosmarrëveshjeve, blerësi dhe shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s.

20.2 Palët në çdo rast kanë të drejtën e zgjidhjes së konfliktit në rrugë gjyqësore ose në arbitrash sipas përcaktimeve të bëra nga vetë palët. Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve, që rrjedhin nga kjo kontratë do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 21

Personat përgjegjës (administratorët) të kontratës

21.1 Secila palë do të caktojë në këtë kontratë personin që do të jetë përgjegjës, për interes të palës respektive, për kryerjen e komunikimeve përkatëse dhe për përfaqësimin e saj në problematikat që lidhen me ekzekutimin e kësaj kontrate.

21.2 Secila palë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për ndonjë ndryshim lidhur me personin e caktuar përgjegjës. Nëse ndonjëra nga palët nuk bën informimet e duhura, atëherë pala do të marrë mbi vete të gjitha përgjegjësitë lidhur me ndonjë dëm të mundshëm që rrjedh si rezultat i mosdhënies së informacionit të nevojshëm.

21.3 Personat përgjegjës të kësaj kontrate për palët, sipas paragrafit të parë të këtij neni, do të jenë respektivisht:

Për blerësin _____

Për shitësin: _____

Neni 22

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje të barasvlefshme nga të cilat 2 kopje qëndrojnë në KESH sh.a. (FSHP) dhe 2 kopje i mban shitësi.

Për shitësin

Emërtimi juridik i palës

Personi i autorizuar i palës _____

Funksioni: _____

Nënshkrimi dhe vula _____

Për blerësin

KESH sh.a.(FPSH)

VENDIM

Nr.81, datë 4.11.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË ALB WIND ENERGY SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë ALB WIND ENERGY sh.p.k.,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolike, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi afatet për realizimin e kushteve të shprehura në pikat 1 dhe 4 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.13, datë 28.01.2008 “Për dhënien e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.143, datë 29.12.2008.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.82, datë 4.11.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS NR.16, SERIA PV04P, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR.39, DATË 22.07.2004 PËR SHOQËRINË “WTS ENERGJI” SHPK, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, neneve 10 dhe 15 pika 2 germa “c” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.07.2004, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k., të ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 09.04.2009

Dhe konstatoi se janë paraqitur në përputhje me rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”:

- Informacione me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. (neni 15, pika 4, germa “a”).

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar ndryshim licence (neni 15, pika 4, germa “b”).

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.39, datë 22.07.2004 për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k., të ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 09.04.2009.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.83, datë 4.11.2009

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TEODORI 2003” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 13, 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., për t`u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson plotësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike,

- Të formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Të dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Të dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Të dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4),

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Zall Bulqizë me fuqi 5.350 MW dhe HEC i Ternovës me fuqi 8.385 MW.

2. “TEODORI 2003” sh.p.k. të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Zall Bulqizë dhe HEC i Ternovës sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

3. Afati i vlefshmërisë se licencës të jetë 30 vjet.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.84, datë 4.11.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 13 pikat 1, germa “d”, dhe 8 pika 2 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.85, datë 4.11.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “CEZ TRADE
ALBANIA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” dhe 45 pikat 3, 4 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
 2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 3.12.2009
 Doli nga shtypi më 3.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë